

# AKT THEMELIMI DHE STATUTI “NETALB” SHPK

## AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “NETALB” SHPK



**AKT THEMELIMI DHE STATUTI "NETALB" SHPK**

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "NETALB" SHPK**

**KREU I  
EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1  
EMRI I SHOQËRISË**

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "NETALB" SHPK.

**NENI 2  
SELIA**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Zona Kadastrale 8532 , Lagjja Nr-2, rruga "Fier - Berat", kilometri i pare Rroskovec , Fier , Shqiperi.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3  
KOHËZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar.

**NENI 4  
OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:
- a) Shërbime interneti dhe telefonike,kabllor;
  - b) Import - eksport i mallrave industriale, ushqimore;
  - c) Transport mallrash;
  - d) Prodhim dhe tregtim te materialeve te ndertimit;
  - e) Veprimtari ne fushen e perpunimit dhe perfundimit te materialeve me mall te porositesit;
  - f) Punime artistike, qendistari, rrobaqepesi, bizhuteri;
  - g) Aktivitet ne fushen e hoteleri turizmit, bar ,restorant;
  - h) Ndertime civile dhe ekonomike, asfaltim rrugesh,punimemirembajtj eje, sinjalistike etj.

Faqe 3 nga 8

## AKT THEMELIMI DHE STATUTI "NETALB" SHPK

### 4.2 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:

- a) Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;
- b) Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkëinvestitorë, pronarë trualli apo objektsh, operatorë dhe administrues të strukturave turistike;
- c) Mund të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe së të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që katë bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

### 4.3 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushjeve ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

## KREU II

### KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

#### NENI 5

#### KAPITALI I SHOQËRISË

### 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100.000 ( Njëqindmije ) Lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortakët që zotërojnë në 100 % (njëqind përqind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht:

- Z.Tauland Hajdini, shtetas shqiptar, i lindur në Rroskovec, më 21.12.1988, identifikuar me kartën e indentitetit me nr. 034459006 dhe numër personal 1812210171, i cili zotëron 65 % (gjashtedhjetepesepërqinde) të kapitalit, dhe vlera është 65000 Lek
- Z.Saimir Hajdini, shtetas shqiptar, i lindur në Rroskovec, më 30.08.1987, identifikuar me kartën e indentitetit me nr. 035162596 dhe numër personal 170830015G, i cili zotëron 35 % (tridhjetepesepërqinde) të kapitalit; dhe vlera është 35000 Lek.

### 5.2 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

#### NENI 6

#### KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT

### 6.1 Në rast se një ortak apo një bashkëzotërues i një kuote humb jetën, trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmet persona që do të njihet titulli mbi

## AKT THEMELIMI DHE STATUTI "NETALB" SHPK

kuotën nga Shoqëria; por asnjë nga këto parashikime nuk çliron përgjegjësitë e trashëgimtarëve nga çdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhdimit të Shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtarët duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.

- 6.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotëruar i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruar i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse personi i mësipërm zgjedh të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër atëherë ai duhet ta kryejë atë nëpërmjet një akti të vlefshëm të transferimit të kuotës.
- 6.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruar i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesë marrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si zotëruar i kuotës.

### NENI 7

#### ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë në zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.
- 7.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panëshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

### NENI 8

#### ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

XREU III

Faqe 5 nga 8

## AKT THEMELIMI DHE STATUT "NETALB" SHPK

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

#### NENI 9

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.
- 9.4 Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 9.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*) audio ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/ët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.
- 9.7 Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.
- 9.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
- 9.9 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara

## AKT THEMELIMI DHE STATUTI "NETALB" SHPK

më poshtë në nenin 9.12. Në rast se ky quorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.

- 9.12 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të ortakëve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

### KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

#### NENI 10 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 pesë vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektivit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statuti a rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 10.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.
- 10.4 Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.5 Administratore të Shoqërisë do të jetë:
- Z. Tauland Hajdini, shtetas shqiptar, i lindur në Rroskovec, më 21.12.1988, identifikuar me karteidentiteti me n r. 034459006 dhe numër personal I81221017I
  - Z. Saimir Hajdini, shtetas shqiptar, i lindur në Rroskovec, më 30.08.1987, identifikuar me karteidentiteti me n r. 035162596 dhe numër personal I70830015G



## **AKT THEMELIMI DHE STATUTI "NETALB" SHPK**

### **NENI 11**

#### **SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë.

#### **PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT**

- 22.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:
- (a) i përfundon mandati;
  - (b) sh karkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
  - (c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
  - (d) personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
  - (e) mungon pa arsye në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazidhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.

### **KREU V**

#### **KONTROLI FINANCIAR I SHOQËRISË, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI**

### **NENI 13**

#### **KONTROLI FINANCIAR**

- 13.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar. Asambleja e Përgjithshme do të emëroje një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

### **NENI 14**

#### **VITI FINANCIAR**

- 14.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

### **NENI 15**

#### **BILANCI VJETOR**

- 15.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.
- 15.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

### **NENI 16**

#### **DIVIDENDI**

- 16.1 Pasi të jenë përmbushur nr kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë të

## **AKT THEMELIMI DHE STATUTI "NETALB" SHPK**

Përgjithsh me, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

- 16.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendët duhet të deklarohen dhe paguhen si pas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjitha dividendët do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumate paguara mbi kuotat gjatë çdo pjese ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividendi.

### **KREU VI PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM, ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE**

#### **NENI 17 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

- 17.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

#### **NENI 18 LIGJI I ZBATUESHEM**

- 18.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statutin dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

#### **NENI 19 ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE**

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë në një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhëshqipe.

#### **ORTAKËT**

**Tauland Hajdini**

**Saimir Hajdini**

**Datë 15.02.2021**

Page 8 nga 8